

AKT NORMATIV
Nr.6, datë 21.3.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.88/2019,
“PËR BUXHETIN E VITIT 2020”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Nenet 1, 2 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 1

Buxheti për vitin 2020 është:

Të ardhurat	489 675 milionë lekë;
Shpenzimet	558 374 milionë lekë;
Deficiti	68 699 milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2020 është :

Të ardhurat	358 706 milionë lekë;
Shpenzimet	427 405 milionë lekë;
Deficiti	68 699 milionë lekë.

...

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore, për vitin 2020, është:

Të ardhurat, gjithsej,	45 304 milionë lekë;
Nga të cilat:	

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| - transferimet nga buxheti i shtetit | 30 888 milionë lekë; |
| - shpenzimet | 45 304 milionë lekë. |

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 11 000 milionë lekësh, përfshirë edhe detyrimet e prapambetura.

Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fondi antiCovid-19, prej 2 500 milionë lekësh, detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, për shpenzime korrente dhe kapitale.”.

Neni 2

Paragrafi i tretë, i nenit 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Fondi prej 20 miliardë lekësh shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, të miratuar në tabelën 1, përmendur në nenin 11, të këtij ligji, si dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, të miratuar në tabelën 3, përmendur në nenin 15, të këtij ligji.”.

Neni 3

Nenet 9 dhe 10 ndryshohen, si më poshtë vijon

“Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	23 000 milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	314 121 milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	21 585 milionë lekë.”.

Neni 10

Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit prej 68 699 milionë lekësh, nëpërmjet huamarrjes totale neto, nga burime të brendshme dhe të huaja, është 72 845 milionë lekë. Brenda këtij kufiri të huamarrjes totale neto përfshihet edhe emetimi i mundshëm i një eurobondi me vlerë indikative prej 80 177 milionë lekësh. Ky kufi i huamarrjes totale neto mund të tejkalohet vetëm në rastet e përcaktuara në nenin 20, të këtij ligji.

Çdo diferencë që mund të rezultojë midis huamarrjes totale neto dhe deficitit të buxhetit të shtetit, në rast teprice akumulohet në llogarinë e qeverisë në Bankën e Shqipërisë ose në rast mungese përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

Në raste pamundësie të financimit të deficitit buxhetor nëpërmjet dy burimeve të mësipërme, Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2020, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes totale neto dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila, automatikisht, rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2, të këtij ligji.”.

Neni 4

Në nenin 11 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime të buxhetit qendror	414 205 milionë lekë;
Fondi rezervë	9 200 milionë lekë;
Kontingjencë për risqet e borxhit	4 000 milionë lekë.”.

2. Në fund të nenit shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Fondi prej 2 000 milionë lekësh, në zërin “Shpenzime kapitale të brendshme” në programin “Mbështetje për shëndetësinë” të Ministrisë së Mbrojtjes, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, për mbështetjen në shërbimin spitalor civil e ushtarak dhe shërbimet komunitare, si për shpenzime korrente ashtu edhe kapitale, mbi kufijtë e përcaktuar në nenin 17, të këtij ligji.”.

Neni 5

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Numri i punonjësve bëhet 82 471 veta.
2. Tabela 2,e përmendur në këtë nen, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 6

Neni 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 14

Fondi rezervë i buxhetit prej 9 200 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave, si më poshtë vijon:

- 1 700 milionë lekë për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme;
- 6 500 milionë lekë si kontingjencë për paketën sociale antiCovid-19;
- 1 000 milionë lekë për emergjenca të tjera në kuadër të masave antiCOVID-19.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 000 milionë lekësh përdoret nga ministri përgjegjës për financat, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë i buxhetit dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, të këtij ligji.”.

Neni 7

Në fund të nenit 15 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Fondet e trashëguara nga vitet e mëparshme përdoren nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas rregullave të përcaktuara nga ministri përgjegjës për financat.”.

Neni 8

Nenet 19 dhe 20 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 19

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2020, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 84 345 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë huamarrjen e brendshme dhe atë të huaj, deri në 72 845 milionë lekë.
- Për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 11 500 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 197 139 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 143 036 milionë lekë.
- Stoku i borxhit të garantur nga qeverisja qendrore 53 353 milionë lekë.
- Stoku i borxhit të qeverisjes vendore 750 milionë lekë.

Neni 20

Në rast të emetimit të një eurobondi të ri, vlera e të cilit mund të jetë më e lartë sesa vlera indikative prej 80 177 milionë lekësh, e shprehur në nenin 6, të këtij ligji, si dhe në rast të disbursimit të ndonjë kredie shtesë në formën e “mbështetjes buxhetore” nga institucionet financiare ndërkombëtare, kufijtë respektivë për huamarrjen totale neto, rritjen vjetore të borxhit të qeverisjes qendrore dhe nivelin e vlerësuar të stokut total të borxhit publik, të përcaktuara në nenet 6 dhe 11, mund të tejkalohen deri në shumën e dy vlerave të mëposhtme:

- Diferenca midis vlerës faktike të eurobondit të emetuar dhe vlerës indikative prej 80 177 milionë lekësh.

- Vlera e kredisë në formën e “mbështetjes buxhetore” të disbursuar.

Ndërkohë, niveli i deficitit të buxhetit të vitit 2020 mbetet i pandryshuar, sipas përcaktimit në nenin 1.

Qeveria mund të akumulojë dhe mund të mbajë në llogarinë e qeverisë në Bankën e Shqipërisë çdo gjendje shtesë të likuiditetit që mund të krijohet dhe mbartet për të financuar buxhetet e viteve fiskale pasardhëse, por në mbyllje të vitit buxhetor gjendja e akumuluar nuk duhet të kalojë vlerën mesatare prej dy muajsh kumulativë të shpenzimeve buxhetore.”.

Neni 9

Tabelat 1 dhe 4, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohen, përkatësisht, me tabelat me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

Neni 10

Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 11

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Kodmin	Emertimi i Ministrisë / Institucionit Buxhetor	AN 2020
1	Presidenca	86
2	Kuvendi	407
3	Kryeministria	173
5	Ministria e Bujqësisë	1,952
6	Ministria e Infrastrukturës /Energjisë	1,024
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	5,986
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	31,063
12	Ministria e Kulturës	1,002
13	Ministria e Shendetësisë	4,257
14	Ministria e Drejtësisë	5,322
15	Ministër Punët e Jashtme	565
16	Ministria e Brendshme	14,264
17	Ministria e Mbrojtjes	8,866
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	998
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	139
22	Akademia e Shkencës	29
24	Kontrolli Lartë i Shtetit	203
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1,099
28	Prokuroria e Përgjithshme	928
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	1,593
30	Gjykata Kushtetuese	62
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	50
35	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	65
41	SPAK/Byro hetimi	100
50	Instituti Statistikës	236
55	Shkolla e Magjistraturës	35
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9
63	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	64
63	Kolegji i Posacem i Apelit	43
63	Komisioneri Publik	30
63	Inspektoriati Lartë i Drejtësisë	40
66	Avokati i Popullit	56
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	31
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	71
76	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	70
77	Autoriteti i Konkurrencës	46
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	Institucione të tjera Qeveritare	1,197
	<i>Drejtoria Sigurimit të Informacionit Klasifikuar (DSIK)</i>	38
	<i>Agjencia e Prokurimit Publik</i>	44
	<i>Komiteti për Pakicat Kombëtare</i>	20
	<i>Inspektoriati Qendror</i>	21
	<i>Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore</i>	83
	<i>Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit</i>	8
	<i>Agjencia për Diasporën</i>	15
	<i>Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët</i>	12
	<i>Qendra Botimeve të Diasporës</i>	15
	<i>Agjencia për Hapje, Dialog dhe Bashkeqeverisje</i>	42
	<i>Agjencia e Zhvillimit të Territorit</i>	43
	<i>Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit</i>	41
	<i>Agjencia Autonome e Auditimit të Fondave të BE</i>	21
	<i>Agjencia Kombëtare e Shërbimeve Publike (ADISA)</i>	332
	<i>Agjencia Ofrimit të Shërbimeve Publike (ADISA)</i>	185
	<i>Komiteti Shtetëror i Kulteve</i>	10
	<i>Departamenti i Administratës Publike</i>	61
	<i>Shkolla Shqiptare e Administratës Publike</i>	23
	<i>Autoriteti Komb. Cert. Elektrikë (ACEK)</i>	24
	<i>Sekretariati Teknik i KEK</i>	6
	<i>Autoriteti Shtetëror Gjeohapsinor (ASIG)</i>	46

	<i>Avokatura e Shtetit</i>	<i>107</i>
88	Mbështetje për shoqërinë civile	16
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	39
90	Komisioni i Prokurimit Publik	36
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	34
92	Instituti i studimeve të krimeve të komunizmit	19
95	Autoriteti Drejtën e Informimit për Dokumentet ish-sigurimit	50
	Total punonjës buxhetorë	82,348
	<i>Rezervë për institucione të qeverisjes qendrore</i>	<i>110</i>
	Total numri i punonjësve	82,458

TREGUESIT FISKALË TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2020

FISCAL INDICATORS REGARDING CONSOLIDATED BUDGET OF 2020

në milion lekë (in million lek)

Nr .	E M Ë R T I M I	Akti Normati v 2020	Ne % te PBB	I T E M S
I.	TOTALI I TË ARDHURAVE	489,675	28.1 %	TOTAL REVENUE
	Te ardhura nga ndihmat	23,000	1.3%	Grants
	<i>Nga te cilat: mbeshtetje buxhetore</i>	<i>2,500</i>	<i>0.1%</i>	<i>from which: Budget Support</i>
	<i>Nga te cilat: grante per fondin e rindertimit</i>	<i>7,000</i>	<i>0.4%</i>	<i>from which: Reconstruction Fund</i>
II.	Te ardhura tatimore	445,090	25.6 %	Tax Revenue
II. 1	Nga Tatimet dhe Doganat	314,121	18.0 %	From tax offices and customs
	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	142,621	8.2%	V.A.T
	Tatimi mbi Fitimin	34,000	2.0%	Profit Tax
	Akcizat	47,000	2.7%	Excise Tax
	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	44,500	2.6%	Personal Income Tax
	Taksa Nacionale dhe te tjera	39,000	2.2%	National Taxes and others
	Taksa Doganore	7,000	0.4%	Customs Duties
II. 2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	26,944	1.5%	Local Taxes
	Taksa Lokale	21,222	1.2%	Local Taxes
	Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)	5,354	0.3%	Property Tax
	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel	369	0.0%	Simple profit tax of small business
II. 3	Te ardhurat nga Fondet Speciale	104,025	6.0%	Revenues from Special Funds
	Sigurimi Shoqeror	88,609	5.1%	Social Insurance
	Sigurimi Shendetesor	14,416	0.8%	Health insurance
	Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve	1,000	0.1%	Revenues for owners' in value-compensation
III .	Te ardhura Jotatimore	21,585	1.2%	Nontax Revenue
	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	1,000	0.1%	Profit transfer from BOA
	Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	11,560	0.7%	Income of budgetary institutions
	Dividenti	500	0.0%	Divident
	Tarifat e Sherbimeve	3,500	0.2%	Services Fees
	Te tjera	5,025	0.3%	Others
I.	TOTALI I SHPENZIMEVE	558,374	32.1 %	TOTAL EXPENDITURE
I. 1	Shpenzime Korrente	448,335	25.7 %	Current Expenditures
	Personeli	83,023	4.8%	Personnel expenditures
	Paga	70,254	4.0%	Wages
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	11,469	0.7%	Social insurance contributions
	Fondi i vecante i pagave	300	0.0%	Bonus fund
	Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta	1,000	0.1%	Higher Education from its own revenues
2	Interesat	41,450	2.4%	Interest
	Te Brendshme	24,000	1.4%	Domestic
	Te Huaja	13,450	0.8%	Foreign
	Kontingjencë për risqet e borxhit	4,000	0.2%	Contingency for debt related risks
3	Shpenzime Operative Mirembajtje nga	50,626	2.9%	Operational & Maintenance of which:

	te cilat:				
	<i>Te qeverisjes qendrore</i>	47,326	2.7%		<i>Central government from revenues of Higher Education System</i>
	<i>Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta</i>	1,000	0.1%		<i>from Exceptional Revenues</i>
	<i>Te tjera jashte limitit</i>	2,300	0.1%		
4	Subvencionet	1,290	0.1%		Subsidies
5	Shpenzime per Fondet Speciale	189,792	%		Social insurance outlays
	Sigurime Shoqerore	137,468	7.9%		Social insurance
	Politika te reja pensionesh	2,520	0.1%		Contingency for new pension policies
	Sigurime Shendetesore	45,304	2.6%		Health insurance
	<i>Nga e cila: Mbeshtetjen shendetesore anti-COVID</i>	2,500	0.1%		
	Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve	4,500	0.3%		Expenditure for owners' in value-compensation
6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	57,554	3.3%		Local Budget expenditure
	Transferrat nga Buxheti i Shtetit per pushtetin vendor	26,040	1.5%		Central Government Grant for Local Government
	<i>Transferte e pakushtezuar e pergjithshme</i>	18,200	1.0%		<i>Unconditional Fund</i>
	<i>Transferte e pakushtezuar sektoriale (Grant Specifik)</i>	7,840	0.5%		<i>Specific Grant</i>
	Buxheti vendor (te ardhurat e veta tatimore)	26,944	1.5%		Local Budget (Own revenues)
	Taksa te ndara	670	0.0%		Local Budget (from shared taxes revenues)
	Buxheti vendor (te ardhurat e veta jo-tatimore)	2,900	0.2%		Local Budget (from non-tax revenues)
	Financimi i huaj vendor	1,000	0.1%		Local foreign financing
7	Shpenzime te tjera	24,600	1.4%		Other expenditures
	Pagesa e Papunesise	600	0.0%		Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike dhe Paaftesia	21,000	1.2%		Social assistance and disability
	Kompensim per ish te perndjekurit politike	1,000	0.1%		Compensation for ex political prisoners
	Bonusi i lindjeve	2,000	0.1%		Birth Bonus
II.	Fondi Rezerve	9,200	0.5%		Reserve fund, Contingency
	Fondi Rezerve	2,700	0.2%		Reserve Fund
	Kontigjenca per paketen sociale anti-COVID	6,500	0.4%		Contingency for deficit financing
III	Shpenzime Kapitale	80,839	4.6%		Capital expenditures
	Financimi Brendshem	50,521	2.9%		Domestic financing
	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte	1,000	0.1%		From Higher Education System's own revenues
	Financimi Huaj	29,318	1.7%		Foreign financing
	<i>nga te cilat: Energjia</i>	1,500	0.1%		<i>from which: Energy</i>
IV	Fondi I Rindertimit	20,000	1.1%		Reconstruction Fund
	DEFICITI	-68,699	-3.9%		Cash Balance
	FINANCIMI DEFICITIT	68,699	3.9%		Financing (Cash)
	Brendshem	35,754	2.1%		Domestic
	Te ardhura nga privatizimi		0.0%		Privatization receipts
	Hua-marrje e brendshme	39,900	2.3%		Domestic borrowing
	Te tjera	-4,146	-0.2%		Other
	I Huaj	32,945	1.9%		Foreign
	Hua afatgjate (e marre)	95,995	5.5%		Long-term Loan(Drawings)
	Ndryshimi i gjendjes se arkës	0			Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-66,550	-3.8%		Repayments
	Mbeshtetje buxhetore	3,500	0.2%		Budget support
	Produkti i Brendshem Bruto (PBB)	1,741,639	100.0%		Gross Domestic Product (GDP)

Kodi	Emërtimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
1	Presidenca	246,300	6,000	0	6,000	252,300
01120	Veprimtaria e Presidentit	246,300	6,000	0	6,000	252,300
2	Kuvendi	1,113,160	228,000	0	228,000	1,341,160
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	414,425	228,000	0	228,000	642,425
01120	Veprimtaria Ligjvënëse	698,735	0	0	0	698,735
3	Kryeministria	437,000	54,000	100,000	154,000	591,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	437,000	54,000	100,000	154,000	591,000
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	4,078,000	3,262,000	3,772,000	7,034,000	11,112,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	386,000	25,000	0	25,000	411,000
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,254,000	195,204	447,918	643,122	1,897,122
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	655,000	2,200,000	755,800	2,955,800	3,610,800
04250	Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq. Blek, Agroind dhe Market.	1,135,000	644,761	1,895,682	2,540,443	3,675,443
04860	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	508,000	16,000	0	16,000	524,000
05470	Menaxhimi qëndrueshem i tokës bujqësore	27,000	0	0	0	27,000
04230	Mbështetje për Peshkimin	113,000	181,035	672,600	853,635	966,635
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	4,048,015	21,081,072	14,829,543	35,910,615	39,958,630
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	540,456	9,500	0	9,500	549,956
04520	Transporti rrugor	1,505,000	14,445,800	6,108,132	20,553,932	22,058,932
04540	Transporti Detar	110,009	45,000	0	45,000	155,009
04550	Transporti Hekurudhor	423,700	165,700	1,200,000	1,365,700	1,789,400
04560	Transporti Ajror	20,200	35,000	0	35,000	55,200
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	373,500	3,969,800	4,411,411	8,381,211	8,754,711
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	500,000	1,962,272	630,000	2,592,272	3,092,272
04320	Mbështetje për Energjinë	102,900	228,000	2,260,000	2,488,000	2,590,900
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	147,000	57,000	0	57,000	204,000
04440	Mbështetje për Industrinë	294,150	85,000	0	85,000	379,150
06180	Planifikimi Urban	31,100	78,000	220,000	298,000	329,100
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	57,812,450	1,906,689	1,138,000	3,044,689	60,857,139
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	594,000	193,000	200,000	393,000	987,000
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	377,000	0	0	0	377,000
01130	Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme	300,000	200,000	0	200,000	500,000
01140	Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2,530,000	417,000	0	417,000	2,947,000
01150	Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	3,275,000	173,220	84,100	257,320	3,532,320
01160	Lufta kundër Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	78,900	2,000	0	2,000	80,900
04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	309,500	70,000	150,000	220,000	529,500
04160	Mbështetje për Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr.	329,500	16,000	0	16,000	345,500
10220	Sigurimi Shoqëror	43,805,750	0	0	0	43,805,750
10550	Tregu i Punës	1,669,000	30,000	0	30,000	1,699,000
04170	Inspektimi në Punë	176,300	10,000	0	10,000	186,300
09240	Arsimi i Mesëm (profesional)	2,058,500	475,469	703,900	1,179,369	3,237,869
06190	Strehimi	2,309,000	320,000	0	320,000	2,629,000
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	38,158,763	3,605,000	216,000	3,821,000	41,979,763
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	703,000	32,000	0	32,000	735,000
09120	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	21,683,720	1,737,000	0	1,737,000	23,420,720
09230	Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)	6,252,043	1,112,000	0	1,112,000	7,364,043
09450	Arsimi Universitar	9,000,000	530,000	100,000	630,000	9,630,000
09770	Fonde për Shkencën	300,000	100,000	100,000	200,000	500,000
08140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë	220,000	94,000	16,000	110,000	330,000
12	Ministria e Kultures	1,488,881	587,000	180,323	767,323	2,256,204
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	165,000	0	0	0	165,000
08220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete	555,881	7,500	35,323	42,823	598,704
08230	Arti dhe Kultura	768,000	579,500	145,000	724,500	1,492,500
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	61,137,940	1,922,000	1,110,000	3,032,000	64,169,940
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	418,940	4,128	0	4,128	423,068
07220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	7,636,862	526,276	158,000	684,276	8,321,138
07330	Sherbimet e Kujdesit Dytesor	24,902,450	1,306,014	852,000	2,158,014	27,060,464
07450	Sherbimet e Shëndetit Publik	2,984,428	23,500	0	23,500	3,007,928
07460	Sherbimi Kombëtar i Urgjencës	310,000	23,182	0	23,182	333,182
10430	Perkujdesi Social	23,849,260	37,700	100,000	137,700	23,986,960
01190	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	1,036,000	1,200	0	1,200	1,037,200
14	Ministria e Drejtësisë	10,042,216	539,174	225,000	764,174	10,806,390
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	385,957	150,300	225,000	375,300	761,257
03310	Ndihma Juridike	60,200	0	0	0	60,200
01120	Publikimet Zyrtare	51,453	5,000	0	5,000	56,453

Kodi	Emërtimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
01130	Mjekësia Ligjore	75,940	10,000	0	10,000	85,940
03440	Sistemi i Burgjeve	5,362,916	370,374	0	370,374	5,733,290
03350	Sherbimi i Pembarimit Gjyqësor	149,000	0	0	0	149,000
01160	Sherbimet per çështjet e biresimeve	14,350	2,000	0	2,000	16,350
01180	Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	3,744,300	1,000	0	1,000	3,745,300
03490	Sherbimi i Proves	198,100	500	0	500	198,600
15	Ministria e Evropes dhe Punëve të Jashtme	3,252,100	29,500	134,780	164,280	3,416,380
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	142,600	2,000	0	2,000	144,600
01120	Mbeshtetje diplomatike jashte shtetit	2,761,500	7,000	0	7,000	2,768,500
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	252,000	0	0	0	252,000
01150	Mbeshtetja Institucionale per Procesin e Integritimit	96,000	20,500	134,780	155,280	251,280
16	Ministria e Brendshme	18,813,229	903,551	818,868	1,722,419	20,535,648
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	980,000	39,400	0	39,400	1,019,400
03140	Policia e Shtetit	15,190,729	717,151	818,868	1,536,019	16,726,748
03150	Garda e Republikës	1,506,000	100,000	0	100,000	1,606,000
01160	Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara te Pushtetit Vendor	483,000	45,000	0	45,000	528,000
01170	Sherbimi i Gjendjes Civile	653,500	2,000	0	2,000	655,500
17	Ministria e Mbrojtjes	19,758,845	4,230,750	119,250	4,350,000	24,108,845
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,189,000	20,000	0	20,000	1,209,000
02120	Forcat e Luftimit	5,614,521	2,231,264	0	2,231,264	7,845,785
09430	Arsimi Ushtarak	600,050	110,000	0	110,000	710,050
02150	Mbeshtetja e Luftimit	5,723,410	230,800	0	230,800	5,954,210
07340	Mbeshtetje per Shendetesine	1,276,864	1,618,686	0	1,618,686	2,895,550
10270	Mbeshtetje Sociale per Ushtaraket	5,060,000	0	0	0	5,060,000
10910	Emergjencat Civile	295,000	20,000	119,250	139,250	434,250
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	1,820,000	39,500	0	39,500	1,859,500
03520	Veprimtaria Informative Shtetore	1,820,000	39,500	0	39,500	1,859,500
19	Drejtoria e Radio Televizionit	564,000	70,000	0	70,000	634,000
08310	Sherbimet per shqiptaret jashte kufirit	270,000	0	0	0	270,000
08520	Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja	180,000	70,000	0	70,000	250,000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarekombetare	60,000	0	0	0	60,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH dhe Kinematografise	54,000	0	0	0	54,000
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	182,000	105,000	0	105,000	287,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	182,000	105,000	0	105,000	287,000
22	Akademia e Shkencës	105,000	1,000	0	1,000	106,000
01520	Veprimtaria Akademike	105,000	1,000	0	1,000	106,000
24	Kontrolli Lartë i Shtetit	397,000	29,000	18,036	47,036	444,036
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	397,000	29,000	18,036	47,036	444,036
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1,310,630	540,400	390,000	930,400	2,241,030
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	201,000	2,000	0	2,000	203,000
05320	Programe per mbrojtjen e Mjedisit	494,000	183,088	290,000	473,088	967,088
04260	Administrimi i Pyjeve	437,000	89,812	50,000	139,812	576,812
04760	Zhvillimi i Turizmit	178,630	265,500	50,000	315,500	494,130
28	Prokuroria e Përgjithshme	2,178,800	130,000	0	130,000	2,308,800
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,178,800	130,000	0	130,000	2,308,800
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	3,201,150	208,000	0	208,000	3,409,150
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	275,150	49,600	0	49,600	324,750
03310	Buxheti Gjyqësor	2,926,000	158,400	0	158,400	3,084,400
30	Gjykata Kushtetuese	145,000	2,000	0	2,000	147,000
03320	Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese	145,000	2,000	0	2,000	147,000
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	61,000	1,000	0	1,000	62,000
08320	Veprimtaria Telegrafike e ATSH-se	61,000	1,000	0	1,000	62,000
35	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	135,324	17,000	0	17,000	152,324
01110	Veprimtaria e KLP	135,324	17,000	0	17,000	152,324
40	Partitë Politike	150,000	0	0	0	150,000
01110	Mbeshtetje per Partite Politike	140,000	0	0	0	140,000
01120	Mbeshtetje per Shoqatat	8,000	0	0	0	8,000
01130	Mbeshtetje per Organizatat e Veteraneve me Status	2,000	0	0	0	2,000
41	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	341,055	20,000	0	20,000	361,055
03390	Veprimtaria e SPAK	341,055	20,000	0	20,000	361,055
50	Instituti Statistikës	639,000	94,000	300,000	394,000	1,033,000
01320	Veprimtaria Statistikore	639,000	94,000	300,000	394,000	1,033,000
55	Shkolla e Magjistraturës	189,000	3,000	0	3,000	192,000
09820	Veprimtaria Arsimore	189,000	3,000	0	3,000	192,000

Kodi	Emërtimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	9,196,000	5,702,000	14,898,000	14,898,000
06210	Programe Zhvillimi	0	4,496,000	5,702,000	10,198,000	10,198,000
06220	Infrastruktura Vendore dhe Rajonale	0	4,500,000	0	4,500,000	4,500,000
04230	Programi "100 Fshatrat"	0	200,000	0	200,000	200,000
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	156,120	1,000	13,400	14,400	170,520
08220	Mbeshetja e veprimtarisë kinematografike	156,120	1,000	13,400	14,400	170,520
63	Institucionet e sistemit të drejtësisë	470,600	14,000	0	14,000	484,600
03320	Veprimtaria e Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë	93,200	7,000	0	7,000	100,200
03330	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magistratit	186,200	4,000	0	4,000	190,200
03340	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	125,000	2,000	0	2,000	127,000
03360	Veprimtaria e komisionerit publik	66,200	1,000	0	1,000	67,200
66	Avokati i Popullit	115,500	1,000	0	1,000	116,500
03320	Sherbimi i avokatise	115,500	1,000	0	1,000	116,500
67	Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil	55,466	1,000	0	1,000	56,466
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	55,466	1,000	0	1,000	56,466
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	132,600	500	0	500	133,100
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	132,600	500	0	500	133,100
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	156,500	2,000	0	2,000	158,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	156,500	2,000	0	2,000	158,500
77	Autoriteti i Konkurrencës	76,500	1,000	0	1,000	77,500
04120	Mbikqyrja e tregut & Garantimi i konkurrencës	76,500	1,000	0	1,000	77,500
82	Keshilli Kombëtar i Kontabilitetit	12,120	1,000	0	1,000	13,120
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	12,120	1,000	0	1,000	13,120
87	Institucione të tjera Qeveritare	4,773,856	1,682,864	250,800	1,933,664	6,707,520
01320	Sherbime Qeveritare	250,000	30,000	0	30,000	280,000
01130	Sherbimi i Prokurimit Publik	58,300	1,000	0	1,000	59,300
01120	Sherbimi për diasporën	145,500	76,750	0	76,750	222,250
05640	Administrimi i ujërave	103,000	7,000	93,000	100,000	203,000
05310	Sherbimi i Avokatise Shtetërore	216,000	1,000	0	1,000	217,000
01150	Sherbime të tjera	408,589	36,500	0	36,500	445,089
01140	e-Qeverisja	3,099,567	1,456,614	7,800	1,464,414	4,563,981
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike	361,500	74,000	150,000	224,000	585,500
08480	Mbeshetjet për Kultet Fetare	131,400	0	0	0	131,400
88	Mbeshetjet për Shoqërinë Civile	122,500	1,000	0	1,000	123,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	122,500	1,000	0	1,000	123,500
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	68,626	1,000	0	1,000	69,626
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	68,626	1,000	0	1,000	69,626
90	Komisioni i Prokurimit Publik	72,000	1,000	0	1,000	73,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	72,000	1,000	0	1,000	73,000
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	51,700	1,000	0	1,000	52,700
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	51,700	1,000	0	1,000	52,700
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	34,500	1,000	0	1,000	35,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	34,500	1,000	0	1,000	35,500
95	Autoriteti për të Drejtën e Informimit	82,000	1,000	0	1,000	83,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	82,000	1,000	0	1,000	83,000
TOTALI		238,186,446	50,521,000	29,318,000	79,839,000	318,025,446